

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

7246

DT 24.10.2025

Librazhd më: 23.10.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”

Z.znj. _____

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Martë, datë 28.10.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Tetor** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.09.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha shtator 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për miratim shtesë punonjësish në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.
5. **P/Vendim** “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopoti”
6. **P/Vendim** “ Për dhënie ndihme financiare”.
7. **P/Vendim** “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë Librazhd nëpërmjet marrveshjes për pronat në pronësi të saj”.
8. **P/Vendim** “Mbi propozimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në pronësi të Bashkisë dhe Njësive varësi të saj”.
9. **P/Vendim** “Për dhënie ndihme financiare”.
10. **Të ndryshme:**

- *Ditën e hënë datë 27.10.2025 ora 10:00 të mbledhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU



P/vendim: 27.10.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

PROJEKT-VENDIM

Nr.22 Datë 17.10.2025

“Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtezuar 6%”
(Periudha: SHTATOR 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 77 Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej 77 Familje me një fond: **320,538** lekë. Vlera e ndihmës **252,274** lekë, vlera e energjisë **68,264** lekë
- 2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kritereve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.
- 3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka

KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

RELACION
Nr.22 datë 17.10.2025

“Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar 6%”
(Periudha: SHTATOR 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” percaktohet qarte se kush mund ta perfitoje kete ndihme nga fondi i kushtezuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndesishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituse në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftushme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërore i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike,sociale,shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitoje ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 77 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 77 familje.

2- Te mos perfitojne nuk ka familje.

Njesitë Administrative:

1. Njësia Administrative Qytet	31 Familje me fond	126,122 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	11 Familje me fond	52,062 lekë
3. Njësia Administrative Polis	10 Familje me fond	37,208 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	16 Familje me fond	69,427 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	9 Familje me fond	35,719 lekë


Totali si Bashki 77 familje me fond 320,538 lekë.

Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike

Rexhep Shaka



FONDI 6%

Periudha: SHTATOR 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlllogaritur për fondin 6%	Kompensi mi i Energjisë	Totali	Numri	
							anëtarëve	
1	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3	
2	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
3	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
4	Jonuz Shahin Çota	G30206013H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	3	
5	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
6	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
7	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3	
8	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
9	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
10	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
11	Eduart Xhevrit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	4	
11	Total Njësia Administrative: Hotolisht			39,182	12,880	52,062	23	
1	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	2	
2	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
3	Shyqyrie Belul Blloshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
4	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
5	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
6	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
7	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
8	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1	
9	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
10	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
11	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	

12	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
13	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
14	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
15	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
16	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
17	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
18	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
19	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
20	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
21	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
22	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
23	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
24	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
25	Sabiye Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
26	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
27	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
28	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
29	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
30	Deje Muharem Coha	G45915009K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
31	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
31	Total Njësia Administrative: Librazhd			102,938	23,184	126,122	47
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
3	Nazif Mehmet Qostja	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
4	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
5	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
6	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3
8	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Total Njësia Administrative: Orenje			29,279	6,440	35,719	19

1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Afërdita Rexhep Tanushi	G46125056D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
3	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
4	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Imer Sali Ballolli	G30520374Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
6	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
7	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
8	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
10	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
10	Total Njësia Administrative: Polis			30,768	6,440	37,208	16
1	Ramadan Dalip Allushi	E20103061F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Serme Kamer Qoshku	G65702019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
5	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
6	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
7	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
8	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
10	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
11	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
12	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
13	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
14	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
15	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
16	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
16	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHID			50,107	19,320	69,427	22
77	TOTALI BASHKISË			252,274	68,264	320,538	127

Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike

Rexhep Shaka



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI**

Nr. ____ . Prot

Librazhd më. ____ . ____ . 2025

P / V E N D I M

Nr. ____ datë . ____ . ____ . 2025

P Ë R

**MIRATIM SHITESE PUNONJËSISH NË STACIONIN E SHËRBIMIT TË NBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore “ Kreu i IX neni 54 gërma dh ,
në Shkresën me Nr.Prot. 3588/2 datë 29.04.2024 të Drejtorisë së Përgjithëshme të MZSH –së,
“ Për konfirmimin e shtesës së numrit të punonjësve të MZSH – së Librazhd “, në Aktin Normativ
Nr.10 datë 08.10.2025 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 “ Për buxhetin e vitit
2025 “ të ndryshuar “ me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Librazhd i
mbledhur sot në datën ____ . ____ . 2025 :

V E N D O S I

1. Në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të shtohen edhe 6 punonjës të tjere të nivelit bazë.
2. Numri total i punonjësve të Sektorit të MZSH –së të jetë 22 punonjës.
3. Numri total i punonjësve të Bashkisë të jetë 456.
4. Efektet financiare për pagat dhe sigurimet shoqërore do të përballohen nga fondet e Ministrisë së Financave.
5. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Sherbimeve Sociale.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISE

Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZH
Drejtoria e Burimeve Njerëzore

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin: "Për miratimin e numrit shtesë të punonjësve të MZSH-së"

Të Nderuar Këshilltare!

- ✓ Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 dt 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, Kreu IX, neni 54 "Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak"; pika dh, ku thuhet:
"Në vendimin për miratimin e buxhetit, **miraton gjithashtu dhe numrin maksimal të punonjësve**, të bashkisë, si dhe njësitë e institucioneve buxhetore në varësi të saj,
- ✓ Ne shkresen nr. 3588/2 datë 29.04.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së" Për konfirmimin e shtesës së numrit të punonjësve të MZSH-së" Librazhd.
- ✓ Në Aktin Normativ nr. 10 datë 08.10.2025 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr 115/2024- Për Buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, **po ju paraqisim për shqyrtim dhe miratim shtesën e numrit të punonjësve të MZSH-së Librazhd.**

Për ushtrimin e funksioneve të saj, në realizimin e shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të komunitetit, në realizimin e këtyre shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara në ligj, ose akte të tjera normative, si dhe në të drejtat dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara në ligjin e mësipërm, Bashkia krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi.

Një nga funksionet shumë të rëndësishme të Bashkisë është ai në fushën e **sigurisë publike**
Në strukturën organizative të Bashkisë ky funksion është i organizuar në Drejtorinë e Funksioneve të Patransferueshme, Sektori (Stacioni) i MZSH-së (Sektori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin)

Ky sektor aktualisht ka në strukture 16 punonjës, ofron shërbim në një teritor prej 793.36 km² dhe ka për mision inspektimin, parandalimin, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njerëzve, gjëse së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Për rrespektimin dhe zbatimin e standarteve dhe realizimin me sukses i këtij misioni nga ky sektor kërkohet shtimi i numrit të punonjësve, pasi gjatë ushtrimit të detyrës së këtij sektori kemi hasur vështirësi që lidhen me:

- **Se pari:** Numri i punonjësve të sektorit nuk i pëgjigjet numrit të popullsisë. Bazuar në ligjin nr.152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", për çdo 1500-2000 banorë duhet **1 punonjës zjarrfikës**. Sipas të dhënave zyrtare të gjendjes civile Bashkia Librazhd ka një popullsi prej 43039 banorë dhe duhet të ketë në strukture 22 punonjës.(nga 16 punonjës që ka aktualisht)

- **Se dyti:** Bashkia ka rreth 600 km rrugë rurale që përshkruajnë një teren të vështirë. Në fshatra apo zona të thella mungojnë rrugët për mjetet, ose në raste emergjencash nuk janë funksionale, gjë që e vështirëson edhe më shumë punën e sektorit, pasi bëhet e detyrueshme shuarja, shpëtimi, apo transporti i mjeteve të shuarjes dhe shpëtimit (shkallë, tubi i ujit) nga punonjësit.
- **Se treti:** Sektori ka për mision dhe shpëtimin e jetës se njerëzve, gjësë së gjallë, në aksidente të ndryshme rrugore, që në teritorin e Bashkisë sonë janë të shpeshta, sidomos në rrugët nacionale (Librazhd-Prrenjas, Librazhd-Peshkopi)
- **Se katërti:** Në teritorin e saj Bashkia ka dhe Parkun Kombëtar të Shebenikut, ku mbrojtja nga zjarri i këtij parku është detyrim i Stacionit të MZSH-së Librazhd.
- **Se pesti:** Shtesa e numrit me 6 punonjës të nivelit bazë, është miratuar në ***Këshillin Bashkiak me Vendimin nr 21 dt 28.02.2024, por nuk është zbatuar për arsye se ky shërbim ka si burim financimi Buxhetin e Shtetit (paga, sigurime shoqerore), i cili tani ka e munduruar financimin e këtij ndryshimi me Aktin e Normativ nr. 10. datë 08.10.2025***

Stacioni i MZSH-së është i vetmi sektor që ushtron kompetenca që kanë lidhje, me asistencën teknike në çdo lloj aksidenti, si dhe mbështetjen për shërbimin e ndihmës në raste fatkeqësie natyrore (përmbajtje, tërmete, rrëshqitje natyrore etj), prandaj vëmendja jonë është maksimale për t'a forcuar si në drejtim të shtimit të numrit të punonjësve, ashtu dhe në pajisjen e tyre me infrastrukturën e duhur (pajisjet e punës)

Për gjithë argumentimin dhe gjendjen e këtij shërbimi kërkojmë **shqyrtimin dhe miratimin e këtij Projekt-Vendimi**, për garantimin, përmirësimin dhe kryerjen sa më mirë dhe konform standarteve ligjore të misionit për të cilin është krijuar.

Ju Faleminderit

DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

DREJTORI

Nadire BIÇAKU

P/Vendimi
Nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/10/2025

“SHTESE FONDI PER KLUBIN E FUTBOLLIT SOPOTI ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025” ,Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/10/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesë fondi për klubin e futbollit Sopoti për vitin 2025 në vlerën 2,000,000 lekë sipas kërkesës nr.5643 datë 22.08.2025.
2. Për sigurimin e këtyre fondeve do të përdoret kursimi nga fondi limit i lidhjes së kontratës nr.7180 Datë 22.10.2025 Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukturë për të rinjt e Librazhdit" në strukturën buxhetore si më poshtë:

Pakësim

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 1	231	2,000,000 lekë “Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukturë për të rinjt e Librazhdit" me kod 1280577

Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	8130	0 1	604	2,000,000 lekë Financim ShA Sopoti

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social , Sektori Financës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA

Adresa: Sheshi “ Gjorg Golemi” email: www.bashkialibrazhd.gov.al, info@bashkialibrazhd.gov.al

FINANCA / CAHQ
25.08.2025



5643
Dt 22.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KLUBI I SPORTIT "SOPOTI" Sh.a.

Nr. 22 Prot

Librazhd më 22/08/2025

Lenda: Kërkesë për Shtesë Fondi për
Klubin Sportiv Sopoti SH.A

Drejtuar: Drejtorisë së Financës

KERKESE

1. Në mbështetje të nevojave në rritje të Klubit Sportiv Sopoti ju paraqesim këtë kërkesë për shtesë fondi. Duke qënë se ekipi i sopotit është pretendent për në kategorine e parë, ka punësuar trajner dhe zevendes trajner për të drejtuar ekipin sportive ne sezonin 2025-2026, me qellim përmirsimin e kushteve të stervitjes. Në këtë fazë klubi ka bërë prurje të reja lojtaresh.
2. Nëpërmjet kësaj kerkese, ju paraqesim nevojën për shtim fondi në programin e buxhetit. Vlera shtesë e kërkuar është 2.000.000 lek ku do të bëhet pagesa e trajnerve dhe lojtarve të rinj dhe detyrimi qe kemi me Federaten Shqiptare te Futbollit sipas marveshjes qe disponojm, kto janë shpenzime të paparashikuara.
3. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në performancë dhe zhvillimin e të rinjve të perfshirë në sport.

Duke shpresuar që kerkesa jonë të meret parasysh dhe të pranohet.

Ju faleminderit!

ADMINISTRATORI

Agron Gega





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KLUBI I SPORTIT "SOPOTI: sha

Librazhd me 24 / 10 /2025

RELACION
SHPENZIMESH

Per vitin buxhetor 2025, eshte bere shperndarja e fondit per shperblimet e futbollistave sipas kontratave të lidhura me klubin sportivë, pagat e punëtorve, sigurime, shperblime etj.

Klubi i Sportit SOPOTI Sh.A per mbarevajtjen e mire te ekipit kerkohen fonde shtese.

1. Shperblim i futbollisteve trajner te ekipit 2,000,000 lek

Në kuader te veprimtarive sportive te planifikuara dhe angazhimit te klubit tone ne aktivitetet zyrtare per sezonin sportive 2025-2026 ju paraqesim kerkesen per shtese fondi ne buxhetin e klubit.

Kjo shtesë është e domosdoshme për të përballuar shpenzimet që lidhen me shperblimet.

Klubi i Sportit Sopoti ShA ka krijuar ekip pretendent me lojtarë të rinj, dhe trajner të ekipit Sopoti me vizionin për të kaluar ekipin në kategorinë e parë. Ndodhur në këto kushte kontratat e lojtarve të lidhura me lojtarët dhe trajnerët, kërkohet shtesë fondi për të përballuar anën financiare të Klubit.

Ju lutemi të merrni në shqyrtim këtë kërkesë dhe të vini në dispozicion fondin e nevojshëm.

Duke marrë parasysh nevojat e klubit për të mbuluar të gjitha shpenzimet i gjeni të detajuara me zëra.

Detyrim total 2,000,000 lek

EKONOMISTI

Elton Faqolli



ADMINISTRATORI

Agron Gega

**KLUBI I FUTBOLLIT SOPOTI sha LIBRAZHD
TE DETAJUARA ME ZERA**

Nr	Emertimi I shpenzimeve	Mujore	Muaj	Total viti
1	Shperblim I trajnerve te ekipit			
2	Shperblim I futbollisteve sipas kontratave	2,000,000	1	2,000,000
	TOTALI	2,000,000		2,000,000

EKONOMISTI
Elton Faqolli

ADMINISTRATORI
Agron Gega



RELACION

Lënda: Shtesë fondi në vlerën 2,000,000 (dy milion) lekë për Klub Futbollin “Sopoti”.

Në mbështetje të kërkesës nr.5643 datë 22.08.2025 së paraqitur nga Klubi i Futbollit “Sopoti”, si dhe në funksion të sigurimit të vijimësisë së aktivitetit sportiv deri në përfundim të vitit financiar, paraqitet nevoja për akordimin e një shtese fondi në vlerën 2,000,000 (dy milion) lekë. Ky fond do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve operative, përfshirë kostot e pjesëmarrjes në kampionat, transportin, mirëmbajtjen e infrastrukturës sportive, si dhe detyrimet e tjera të domosdoshme për funksionimin e klubit deri në fund të vitit. Shtesa e fondit do të realizohet nëpërmjet rialokimit të kursimeve të krijuara nga fundi limit i kontratës “Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukturë për të rinjtë e Librazhdit”, pa prekur objektivat e projektit në fjalë.

Fondi limit për objektin “Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukturë për të rinjtë e Librazhdit” ka qënë 31,490,867 lekë në bashkëpunim me AKR (Agjensia Kombëtare e Rinisë) dhe kontrata me nr. 7180 datë 22.10.2025 është lidhur në vlerën 28,034,475 lekë me faza financimi. Për vitin 2025 financimi nga ana e bashkise ka qënë planifikuar 4,398,173 lekë dhe me finalizimin e kontratës financimi për vitin 2025 është 2,398,173 lekë me një kursim 2,000,000 lekë. Gjithashtu kursimi i mbetur është shpërndarë në vitet në vazhdim.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e vazhdimësisë së veprimtarisë sportive të Klubit të Futbollit “Sopoti” propozohet miratimi i shtesës së fondit në vlerën 2,000,000 lekë , që do të mbulohet nga kursimet e fondit të mësipërm.

P/Buxhetit

Emanuela Çekrezi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/10/2025

“PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025” ,Udhëzimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/10/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare z.Gazmir Bahiti në masën 1,000,000 lekë sipas kërkesës me nr .7091 prot datë 16.10.2025 për mbulimin e shpenzimeve të diagnostifikuar me sëmundje të rëndë.
2. Fondi prej 1,000,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2025 “Ndhmë Financiare “ si dhe nga fondi rezervë në strukturën buxhetore si më poshtë:

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 1	606	500,000 lekë Ndhmë financiare

Pakesim

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4910	0 1	609	500,000 lekë Fond rezerve

Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 1	606	500,000 lekë Ndhmë financiare

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit,Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Sektori Financës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISE

MARIGLEN DISHA

RELACION

Lënda: Mbi mbështetjen financiare për z. Gazmir Bahiti .

Në bazë të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga z. Gazmir Bahiti, pjesë e stafit të administratës, bëhet e ditur se ai është diagnostifikuar me një sëmundje të rëndë, e cila kërkon trajtim të specializuar dhe përfshirje të konsiderueshme financiare për mbulimin e kostove mjekësore dhe të transportit. Duke qenë se gjendja shëndetësore e z. Bahiti e ka vendosur atë në një situatë të vështirë ekonomike, si dhe duke marrë parasysh kontributin e tij të vazhdueshëm në administratë dhe në përmbushjen e detyrave të tij funksionale, propozohet që institucioni të akordojë një mbështetje financiare të posaçme për të ndihmuar në përballimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor.

Mbështetja do të realizohet në formën e një ndihme financiare të njëhershme, në vlerën 1,000,000 lekë dhe do të financohet nga fondi i parashikuar për shpenzime “Ndihma financiare “ brenda buxhetit të institucionit.

Fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2025 për ndihma financiare ka qenë 1,500,000 lekë dhe është përdorur gjatë vitit me vendim të Këshillit Bashkiak deri në masën 971,296 lekë. Fondi i mbetur nuk e plotëson mbështetjen financiare që është menduar për z. Gazmir Bahiti për këtë arsye po përdoret fondi rezerv i miratuar në buxhetin e bashkisë në vlerën 500,000 lekë.

Në kuadër të solidaritetit njerëzor dhe përkujdesit ndaj punonjësve të administratës, propozohet miratimi i dhënies së mbështetjes financiare për z. Gazmir Bahit, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të trajtimit të tij shëndetësor.

P/Buxhetit

Emanuela Çekrezi



Keshilli Bashkia
Financa

7091

DE 16.10.2025

KËRKESË/ANKESË

17.10.25

Drejtuar Bashkisë Librazhd

DATE: 16/10/2025

Drejtorisë së

Unë i/e nënshkruari/a Gazmir Bahiti banues në Librazhd

Kërkoj nga ana e Bashkisë Librazhd drejtorisë suaj zgjidhjen e problemit tim i cili është si më poshtë:

Unë punonjesi i Bashkisë Librazhd dhe Kontribues në disa sektore të ndryshme prej 15 vite jam drejtuar me këtë kërkesë për të kërkuar ndihmë financiare për shkak të gjendjes time të vështirë sepse jam diagnostifikuar nga një sëmundje e rëndë, kurimin dhe kimioterapite që i bëj në shtetin Italian.

Aktualisht gjendja ime ekonomike është e vështirë për të përballuar këtë situatë dhe nuk arrij të përballoj për blerjen e ilaçeve dhe pagësen e kimios. Për këtë arsye ju lutem të merren në konsideratë kërkesën time për ndihmë financiare nga fondet e Bashkisë Librazhd.

Në imbeshtetje të kësaj kërrese, po ju bashkëngjitem dokumentacionin përkatës që vërteton gjendjen time.

Shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh nga ana e drejtorisë përkatëse!

Nr.Tel: 0695380686

Nënshkrimi:

Gazmir Bahiti

(emër, mbiemër, firmë)



ASST. MELEGNANO E DELLA MARTESANA
PRESTIDIO OSPEDALIERO DI VIZZOLO FREDEBESSE
LABORATORIO ANALISI - Tel. 0198051
Direttore Dr.ssa Helena Argenti
P.IVA 09320500964

13182023 Page 1

ASST. DEL GRANO, MARTELLANA
VIZZOLI, FREDABISSI

BANITI GAZMIR

ALBANIA

EASY 7188867
 A.T. 00000000003
 Date 11/08/75 Ora 08:53
 TNL 01527518 STAN 00026
 Mod. Online CILS 10
 AUT. 712874 OPER. 0002
 AUTH. RESP. CODE
 PAN *****
 SCAN *****

3/2025

13/08/2028

PRESTAZIONI DI LABORATORIO

```
SCAD *****00000001010  
APPL *****Monte Mario*****  
ATC 079Z ICC 180 LT UN  
TIME 07Z UN ZAD 06Z  
TVR *****0000000000  
ABOC *****HF6FC5CAF35BA47  
LAD 0110A040832200000000  
0000000000000000FF  
CORTA ----- CLIENTE --
```

IMPORTO EUR 51,43

Transazione eseguita

Grazie e arrivederci
B. ca Popolare di Sondrio

TRANSFERASI (GOT - AST)

SFERASI (GPT - ALT)

flex

ANSPEPTIDASI (GGT)

LE PROTEINE PLASMATIQUE

nyio a Phoresis)

1.87	1.87
0.00	0.00
4.18	4.18
1.87	1.87
1.48	1.48
1.87	1.87
1.87	1.87
1.87	1.87
5.72	5.72
0.00	0.00
12.16	12.16
18.54	18.54

51.4 Importo Quota Fissa DGR 2021 del 20/07/2011 0.00

100-154560-10

REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
Qendra Socio-Shendetesore, Librazhd

Nr 41 Prot.

Librazhd, me 20.08.2025



EPIKRIZE

Emri	GAZMIR
Atesia	SERVET
Mblemri	BAHITI
Gjinia	MASHKULL
Date lindja	19.04.1986
Nr. Personal	160419020U
Nr. Kartel	2739
Kod Pacienti	IU02270915
Institucioni	Qendra Socio-Shendetesore, Librazhd.
Anamneza e jetes	Ka lindur dhe eshte zhvilluar nomalisht. Nuk ka kaluar dhe nuk vuan nga semundje infektive. Eshte vaksinuar rregullisht.
Anamneza fmiljare	Nuk ka ne familje me semundje te trasheguara.
Ankesat	Mungese e theksuar oreksi, Renie ne peshe.
Diagnoza	Tumor abdominal me natyre te papercaktuar.
Mjekimi	Pa mjekim
Rekomandime	Referim jashte shtetit (Itali) per kryerje ekzaminime plotesuese te thelluara per sakesim diagnoze dhe percaktim trajtimi e terapie.

MJEKU I FAMILJES



Shyqyri ZOGOLLI
DR SHYQYRI ZOGOLLI
I PERSHITSHEM
08/21/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Nr. ____ Prot

Librazhd me ____/____/2025

PROJEKT-VENDIM

NR.____, Datë _____.____.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR NEGOCIMIN ME ZHVILLUESIT
PRIVAT QË SHPREHIN INTERESIN QË TË BASHKËPUNOJNË ME BASHKINË
LIBRAZHD NËPËRMJET MARRËVESHJES PËR PRONAT NË PRONËSI TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja “c” nenit 23, pika 6, nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 7895, datë “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.____.2025 të :

VENDOSI:

I. Të përgjithshme.

1. Të përcaktojë procedurat e negocimit me zhvilluesit privat të cilët kërkojnë të lidhin marrëveshje sipërmarrje/shkëmbimi me Bashkinë e Librazhd për zhvillimin e pasurive në pronësi të saj, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, kuadrit ligjor të planifikimit të territorit dhe për pasuritë e paluajtshme të shtetit, si dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar .

2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a. “Zhvilluesi privat”, është çdo person fizik ose juridik i cili është pronar apo ka një kontratë sipërmarrje/shkëmbimi apo tagra të tjerë të ligjshëm zhvillimi mbi një apo disa prona kufitare me atë/ato që janë asete të Bashkisë Librazhd dhe që shpreh interesin për nënshkrimin e një marrëveshjeje sipërmarrje/shkëmbimi, por pa u kufizuar vetëm në këto, kundrejt vënies në dispozicion të pronës nga ana e Bashkisë Librazhd.

Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: info@bashkialibrazhd.gov.al

www.bashkialibrazhd.gov.al

b. “Marrëveshje sipërmarrje/shkëmbimi, por pa u kufizuar vetëm në këto”, ka kuptimin e një marrëveshjeje/kontrate që plotëson kushtet në përputhje me parashikimet e Kodit Civil dhe ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nënshkruhet ndërmjet Bashkisë së Librazhd në njërin anë dhe zhvilluesit privat, i cili ofrohet që në shkëmbin të pasurisë të vendosur në dispozicion nga ana e Bashkisë Librazhd, ti jap kësaj të fundit sipërfaqe ndërtimore në përputhje me vlerat e tregut të lirë.

c. “Aset i paluajtshme të Bashkisë Librazhd”, është çdo pronë e paluajtshme në pronësi të Bashkisë Librazhd apo çdo pronë e paluajtshme e transferuar nga pushteti qendror dhe pjesë e listave të inventarit sipas parashikimeve të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar

d. “Nënshkruesi i autorizuar”, është kryetari i bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për të nënshkruar një marrëveshje sipërmarrje/shkëmbimi me zhvilluesin privat, i cili ofrohet për të hyrë në marrëveshje dhe përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

e. “Shprehje interesi”, shfaqja e një interesi të ligjshëm për zhvillimin e pronave të paluajtshme, asete të Bashkisë Librazhd, nga ana një subjekti privat që gëzon tagra ligjorë mbi pronën kufitare me atë të Bashkisë Librazhd nëpërmjet propozimit për të hyrë në marrëveshje me këtë të fundit.

II. Kërkesa për shprehje interesi

3. Çdo kërkesë e paraqitur nga zhvilluesi privat për të hyrë në marrëveshje me Bashkinë Librazhd, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi, parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

4. Kërkesa e zhvilluesit privat për shprehje interesi i drejtohet Drejtorise se Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës, dhe duhet të përmbajë këto elementë:

- Propozimin konkret në lidhje me zhvillimin që kërkohet të realizohet;
- Përcaktimin në mënyrë të saktë hartografike të pronës së Bashkisë Librazhd për të cilën kërkohet marrëveshja;
- Dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese të pronës kufitare private apo marrëveshjet e sipërmarrjes/porosie/shkëmbimit apo të tjera të ngjashme me këto, që subjekti privat ka për këto pasuri, në kufi me pronën në pronësi të Bashkisë Librazhd.

III. Shqyrtimi i kërkesës për shprehje interesi

5. Procedura për shqyrtimin, negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes zbatohet në përputhje me parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, si dhe ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës së Bashkisë Librazhd.

6. Me paraqitjen e kërkesës, Drejtorise se Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës kryen këto veprime:

- a. Verifikon nëpërmjet listave të inventarit nëse pasuria e propozuar për marrëveshje është apo jo pjesë e tyre, si dhe verifikon tagrin ligjor që ka Bashkia Librazhd mbi të;
- b. Merr informacionin zyrtar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për statusin juridik të pasurive që kërkohet të zhvillohet si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm provues tekniko-ligjor.

7. Nëse pasuria e paluajtshme sipas verifikimit të mësipërm, rezulton në pronësi të Bashkisë Librazhd dhe zhvilluesi privat ka një marrëdhënie juridike, ose kontratë sipërmarrjeje, me pronën kufitare në pronësi të Bashkisë së Librazhd, Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës së bashku me statusin juridik të pronave i përcjell kërkesën dhe dokumentacionin përkatës Komisionit të posacën për të marrë në shqyrtim kërkesën në përputhje me kuadrin ligjor të planifikimit të territorit dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.

8. Komisioni i posacën të në përfundim të shqyrtimit e verifikimit të kërkesës, si edhe të dokumentacionit shoqërues, në bashkëpunim me Drejtorise se Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës arrijnë në konkluzionin se:

- a. Kërkesa e paraqitur nga subjekti privat është në përputhje me elementët e planifikimit të territorit dhe PPV-në e Bashkisë Librazhd dhe së bashku me informacionin e siguruar ia përcjellin Komisionit të Negocimit, duke njoftuar edhe zhvilluesin privat për këto veprime.
- b. Kërkesa e paraqitur nga zhvilluesi privat nuk është në përputhje me elementët e planifikimit të territorit, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe vendoset refuzimi i saj. Refuzimi i kërkesës i njoftohet edhe zhvilluesit privat.

IV. Komisioni i negocimit dhe përmbajtja e marrëveshjes

9. Në zbatim të këtij vendimi, për shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të paraqitura nga zhvilluesit privat, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, i cili ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.

10. Anëtarë të këtij komisioni, si rregull janë Zv Kryetari i Bashksisë, përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës, Juristi, përfaqësues nga Sektori i Aseteve dhe Zhvillimit të Territorit dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

11. Nuk mund të marrin pjesë në Komision e Negocimit personat që kanë konflikt interesi me partneritetin privat sipas kuptimit të ligjit “Për konfliktin e interesit”. Anëtarët e Komisionit të Negocimit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e negocimit.

